

**OJQ "NEVO KONCEPTI-NVK"**  
Raporti i Audituesit të pavarur  
Pasqyrat financiare për vitin 2021

---

Prill, 2022

PËRMBAJTJA:

Raporti i audituesit të pavarur	3-4
Pasqyra e pozitës financiare	5
Pasqyra e te ardhurave	6
Pasqyra e rrjedhës së parasë	7
Pasqyra e ndryshimeve në fonde	8
Shënimet e pasqyrave financiare	9-17

## RAPORT I AUDITORIT TE PAVARUR

**Për: Bordin drejtues të OJQ “NEVO KONCEPTI- NVK” - Prizren**

**Raport mbi pasqyrat financiare**

### **Opinion**

Ne kemi Audituar pasqyrat financiare shoqëruese të OJQ “NEVO KONCEPTI-NVK” të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2021, pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyra e ndryshimeve në Fonde, pasqyra e rrjedhës së parasë dhe përmbledhja e politikave kryesore kontabël dhe informatave tjera shpjeguese.

Sipas mendimit tone , pasqyrat financiare te OJQ ‘NEVO KONCEPTI’ prezantojne ne menyre te drejte dhe te sinqerte, ne te gjitha aspektet materiale pozicionin financiar te OJQ-se , performancen financiare si dhe rrjedhen e parase qe perfundon me 31.dhjetor 2021 ne perputhje me bazat e perpilimit te raportimit financiar te pershkruara ne paragrafin 2.1 te ketij raporti.

### **Baza per Opinion**

Ne e kryem auditimin tone ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Auditimit (SNA-te).Pergjegjsite tona sipas ketyre standardeve jane pershkruar ne menyre me te detajuar ne seksionin e raportit ku jepen pergjegjesite e audituesit per pasqyrat financiare. Ne jemi te pavarur nga Shoqeria ne perputhje me kerkesat etike qe jane te zbatueshme per auditimin e pasqyrave financiare ne Kosove dhe kemi permbushur pergjegjesite e tjera etike ne perputhje me keto kerkesa. Ne besojme se evidenca e auditimit qe kemi siguruar eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per te dhene nje baze per opinionin tone.

### **Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare**

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për OJQ “NEVO KONCEPTI-NVK” dhe për kontrollin e brendshëm që menaxhmenti përcakton se është i nevojshëm për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare të lira nga gabimet materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

### **Përgjegjësia e Auditorit**

Përgjegjësia jonë është të shprehim një konkluzion mbi pasqyrat financiare shoqëruese. Ne kemi bërë rishikimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare mbi Angazhimet e Rishikimit (ISRE) 2400 (Rishikuar), Angazhimet për Rishikimin e Pasqyrave Financiare Historike. ISRE 2400 (Rishikuar) kërkon që ne të konkludojmë nëse ndonjë gjë ka ardhur në vëmendjen tonë që na bën të besojmë se pasqyrat financiare, të marra si tërësi, nuk janë të përgatitura në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar. Ky Standard gjithashtu na kërkon që të jemi në pajtueshmëri me kërkesat përkatëse etike. Një rishikim i pasqyrave financiare në përputhje me ISRE 2400 (Rishikuar) është një angazhim me siguri të kufizuar. Auditori kryen procedura, kryesisht të përbëra nga marrjen të pyetjeve të menaxhmentit

dhe të tjerëve brenda entiteti, sipas rastit, dhe zbatimin e procedurave analitike dhe vlerësimin e evidencave të përfuara. Procedurat e kryera në një rishikim janë shumë më të pakta se ato të kryera në një auditim sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Prandaj, ne nuk shprehim opinion të auditimit për këto pasqyra financiare.

Ne gjithashtu:

- Identifikojme dhe vleresojme rreziqet e anomalise materiale, qofte per shkak te mashtrimit ose gabimit, hartojme dhe kryejme procedurat e Rishikimit ne pergjigje te ketyre rreziqeve dhe marrim evidence qe eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per te siguruar nje baze per opinionin tone. Rreziku i moszbulimit te nje anomalie materiale si rezultat i mashtrimit eshte me i larte se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund te perfshije marrveshtje te fshehta, falsifikime, perjashtime te qellimshme, Informacione te deformuara, anashkalime te kontrolleve te brendshme.
- Sigurojme nje njohje te kontrolles se brendshme qe ka te beje me auditimin me qellim qe te percaktojme procedurat e auditimit qe vjane te pershtatshme sipas rrethanave, por jo per qellime te shprehjes se nje opinionin mbi efikasitetin e kontrollit te brendshem te ojq.
- Vleresojme pershtatshmerine e politikave kontabel te perdorura dhe arsyeshmerine e cmuarjeve kontabel dhe shpjegimeve perkatese te bera nga menaxhment.
- Nxjerrim nje konkluzion ne lidhje me pershtatshmerine e perdorimit te bazes kontabel te vijimsise dhe bazuar ne evidencen e auditimit te marre e cila mund te hedhe dyshime te medha per aftesine e ojq per te vijuar veprimtarine. Nese ne arrijme ne perfundim qe ka nje pasiguri ne duhet te terheqim vemendjen ne raportin e audituesit ne lidhje me shpjegimet e dhena ne pasqyra financiare, ose nese keto shpjegime jane te papershtatshme duhet te modifikojme opinionin tone. Konkluzionet tona bazohen ne evidencat e auditimit te marre deri me daten e raportit tone te auditimit. Megjitheate, ngjarje ose kushte te ardhshme mund te bejne qe ojq te nderpres veprimtarine.

Ne konkludojme me personat pergjegjes te ngarkuar me qeverisjen, perveq tjerave, lidhur me kohen e auditimit dhe gjetjet e rendesishme te auditimit perfshire ndonje mangesi te rendesishme ne kontrollin e brendshem qe neve te mund te identifikojme gjate auditimit.

“Kont Audit” NSH  
  
Liman Morina, Auditor Ligjor, lic 008.



Prizren, prill, 2022.

**“ NEVO KONCEPTI-NVK” OJQ**

**NRB: 5115293-0**

**Pasqyra e pozitës financiare  
më 31 dhjetor 2021.**

<b>PASURITË</b>	<b>Shënimi</b>	<b>2021 €</b>	<b>2020 €</b>
<b>Pasuritë afatshkurtra</b>			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	4	5,107	10,467
Parapagimet	5	-	22
Pasuritë e tjera afatshkurtra			
<b>Gjithsej pasuritë afatshkurtra</b>		<b>5,107</b>	<b>10,489</b>
<b>Pasuritë afatgjata</b>			
Prona, pajisjet dhe impiantet	6	-	-
Investimet në vijim		-	-
Pasuritë e shtyra tatimore			
Pasuritë e tjera afatgjata			
<b>Gjithsej pasuritë afatgjata</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Gjithsej pasuritë</b>		<b>5,107</b>	<b>10,489</b>
<b>FONDET DHE DETYRIMET</b>			
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>			
Mbitërheqja bankare			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	7	-	246
Tatimin në fitim i pagueshëm		-	-
Provizionet afatshkurtra			
Detyrimet ndaj pagave, TAP dhe KP	8	5,107	144
<b>Gjithsej detyrimet afatshkurtra</b>		<b>5,107</b>	<b>390</b>
<b>Detyrimet afatgjata</b>			
Detyrimet ndaj pasurisë afatgjatë	6	-	-
Detyrimet e shtyra tatimore			
Detyrimet e tjera afatgjata			
<b>Gjithsej detyrimet afatgjata</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Gjithsej DETYRIMET</b>		<b>5,107</b>	<b>390</b>
<b>FONDET</b>			
Neto rritje/pakesim të fondeve nga periudhat e kaluara		10,099	10,762
Neto rritje/pakesim të fondeve nga periudha vijuese	-	5,360	14,539
Kethimi I fondeve donatoreve		368	15,202
<b>Gjithsej fondet</b>	9	<b>5,107</b>	<b>10,099</b>

Pasqyrat financiare janë përpiluar nga stafi i OJQ-se, janë miratuar më 31.03.2022 dhe janë nënshkruar nga menaxhmenti i saj.

Drejtori Ekzekutiv

Osman Osmani



Kontabilisti i certifikuar

Tasim Shasivari

**“ NEVO KONCEPTI-NVK”**  
**Pasqyra e të ardhurave**  
 për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021.

	Shënimi	€	€
	Shënimi	<b>2021</b>	<b>2020</b>
Të ardhurat nga grantet e donacionet		199,937	230,924
Te ardhurat tjera		1,100	1,863
<b>Gjithesëj te ardhurat</b>	10	<b>201,037</b>	<b>232,787</b>
<b>Shpenzimet</b>			
Shpenzimet programore			
Shpenzimet per paga e meditje bruto		52,830	52,242
Shpenzimet programore		68,966	64,298
Shpenzimet e tjera			
<b>Gjithesëj shpenzime programore</b>	11	<b>121,796</b>	<b>116,540</b>
<b>Menaxhment dhe administrate</b>			
Pagat dhe meditjet bruto		83,050	89,624
Shpenzimet operative		1,436	8,501
Të tjera		-	-
<b>Gjithesëj shpenzimet menaxhment e administrate</b>	12	<b>84,486</b>	<b>98,125</b>
Shpenzimet tjera (zhvleresimi paisjeve	6	115	3,593
<b>Gjithesëj shpenzimet tjera</b>		<b>115</b>	<b>3,593</b>
<b>Totali I shpenzimeve:</b>		<b>206,397</b>	<b>218,258</b>
<b>Neto rritje/ pakesim nga opracionet:</b>			
Shpenzimet e tatimit ne fitim		-	-
<b>Neto rritje/ pakesim I fondeve te periudhes</b>		<b>5,360</b>	<b>14,539</b>
Neto rritje/ pakesim I fond nga periudhat e kaluara		-	-
Shlyerjet e inventarit dhe korigjime		-	-
<b>Fondet e mbajtura ne fund te vitit (te hyrat e shtyra)</b>	9		

**"NEVO KONCEPTI-NVK" OJQ**

**Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021**

<b>Përshkrim</b>	<b>2021</b>	<b>2020</b>
<b>METODA INDIREKTE</b>	<b>€</b>	<b>€</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative</b>		
Fitimi /(humbja)i / e vitit	0	14,539
<b>Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave</b>		
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	0	3,593
<b>Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative</b>		
(Rritja)/Zvoglimi ne parapagime	0	-22
Rritja/(zvoglimi) ne llogarite e pagueshme tregtare dhe te tjera	-253	-4,379
Rritja/(zvoglimi) ne detyrimet ndaj pagave, TMB dhe KP	-5,107	-8,323
Rritja/(zvoglimi) nedetyrimet ndaj pasurise afatgjate	0	-3,593
	<b>-5,360</b>	<b>-16,317</b>
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative</b>	<b>-5,360</b>	<b>1,815</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese</b>		
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	0	0
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investues</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese</b>		
Pagesat e lizingut financiar		
Fondet e Kthyera	0	-15,202
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese</b>	<b>0</b>	<b>-15,202</b>
Rrjedha neto e parase	<b>-5,360</b>	<b>-13,387</b>
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	10,467	23,854
<b>Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit</b>	<b>5,107</b>	<b>10,467</b>

**"NEVO KONCEPTI-NVK" OJQ**  
**Pasqyra e ndryshimeve në Fonde**  
**për periudhen 01.01. deri më 31.12.2021**

	<b>Fondet fillestare</b>	<b>Fondet e akumuluar</b>	<b>Rezervat tjera</b>	<b>Gjithsej</b>
	<b>€</b>	<b>€</b>	<b>€</b>	<b>€</b>
<b>Gjendja më 1 janar 2020</b>		<b>10,762</b>		<b>10,762</b>
Neto rritje/pakesim nga operacionet		14,539		14,539
Kethim I fondeve		(15,202)		(15,202)
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>		<b>10,099</b>		<b>10,099</b>
<b>Gjendja më 1 janar 2021</b>		<b>10,099</b>		<b>10,099</b>
Neto rritje/pakesim nga operacionet	-	(5,360)		5,360
Kethim I fondeve		368		368
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>-</b>	<b>5,107</b>		<b>5,107</b>



**“ NEVO KONCEPTI-NVK” OJQ**  
**Shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare për vitin që përfundon**  
**më 31 dhjetor 2021.**

---

**1. Informata të përgjithshme**

OJQ“NEVO KONCEPTI-NVK ” është një OJQ e regjistruar në Kosovë, themeluar sipas Ligjit Nr. 06/L-43, Neni 15 për Lirine e Asocimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.

- Organizata quhet **“NEVO KONCEPTI”**
- Ajo njihet edhe si OJQ **“NVK”**
- Organizata është Shoqate jofitimprurese sipas definimit të dhënë në Nenin 12 të Ligjit Nr.06/L-043 për Lirine e Asocimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.
- 

**Data e regjistrimit:** 26.nentor.2014  
**NRB:** 5115293-0  
**NRF:** 601188700  
**Kodi:** 9999  
**NRSB:** N/A  
**NR TVSH:** N/A  
**Lloji i shoqërisë:** Organizate Jo Qeveritare  
**Adresa e regjistrimit:** Rr.” Adnan krasniqi”, 149/II/8,Prizren  
**Themeluesit:** Erxhan Galushi, rr. “Haxhi Zeka” nr.47,Prizren, nr personal: 31173002579.  
Edon Korllari, rr. “Xheladin Hana”nr.48, Prizren, nr personal: 1234654574.  
Nurgjan Qorri, rr.” Takova” nr.7 ,Prizren, nr personal: 1170796701.  
**Kryesues i bordit të OJQ:** Daut Qylangji  
**Perfaqësues i OJQ-se:** Osman Osmani, Drejtor Ekzekutiv.

**Veprimtaria, qëllimi dhe misioni i themelimit**

**OJQ “NEVO KONCEPTI-NVK” është themeluar me qëllim të:**

Permiresimit të GJENDJES SE KOMUNITETEVE Rome,Ashkali dhe Egjiptian në fushën e arsimit dhe në fushat tjera të cilat ndikojnë në mirëqenjen e tyre përmes aktiviteteve për ngritjen e vetedijes së komunitetit, fuqizimit të kapaciteteve dhe avokimit , me prioritet integrimin e fëmijëve të komuniteteve në fjalë në procesin mesimor.

**Aktiviteti i Ojq-se per gjate vitit 2021 ka qene i fokusuar ne zhvillimin e projekteve si ne vijim:**

- Risocializimi i te rikthyerve Rom, Ashkali dhe Egjiptian nga europa Perendimore ne Komunen e Prizrenit (REACH II) , i financuar nga Qeveria Gjermane dhe Fondacioni Gjerman Karl Kubel Stiftung fur Kind und Fami3ie (KKS).
- Promovimi i integritit dinjitoz te komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian ne Peje dhe Suhareke (Prospekt+ ), i financuar nga Fondacioni kosovar per Shoqeri te Hapur (KFOS) ne mbeshtetjen e qeverise Gjermane dhe Fondacionit Gjerman Karl Kubel Stiftung fur Kind Und Familie (KKS).
- Perkraja e BE-se per zbatimin e Strategjise per Rom,Ashkali dhe Egjiptian, Faza 2 Edukimi per Integrim (EU SIMRAES 2), i financuar nga Qendra per Edukim e Kosoves (KEC) me mbeshtetjen e Bashkimit Europian (BE).
- Mbeshtetje per edukimin e rregullt te femijeve te riatdhesuar dhe komunitetit pakice ne komunat e Prizrenit dhe Gjakoves, Kosove (CDBE), te financuar nga Deutsche Gesellschaft fur Interncionale Zusammenarbeit- GIZ.
- Qeverisja e te drejtave te femijeve (SIDA), financuar nga Save the Chidren Internacional ne Kosove.

## 2. POLITIKAT KONTABEL

### 2.1 Bazat e pergatitjes

Pasqyrat financiare jane pergatitur ne perputhje me standardet e kontabilitetit dhe Raportimit financiar te zbatueshem ne Republiken e Kosoves dhe ne pajtueshmeri me Ligjin Nr.06/L-43 qe aktualisht jane ne fuqi ne Republiken e Kosoves si dhe mbi bazen e kontabilitetit te percaktuar ne marrveshtjen me donatoret duke perfshire ketu edhe buxhetimin.

### 2.2 Bazt e matjes

Pasqyrat financiare pergatiten ne baze te kostos historike dhe bazes se moderuar te keshit, dhe te ardhurat njihen kur ato inkasohen e jo kur ato fitohen, ndersa shpenzimet njihen kur ato paguhen e jo kur ato ndodhin, modifikimi i bazes se keshit behet vetem per shpenzimet e grumbulluara ne fund te periudhes se raportimit vjetor.

### 2.3 Valuta e raportuese dhe prezantimi

Pasqyrat financiare jane pergatitur dhe prezantuar ne valuten Euro, e cila njeherit eshte valuta funksionale dhe legale ne Republiken e Kosoves.

### 2.4 Sistemi i kontabilitetit

Organizata perdor sistemin e kontabilitetit te zhvilluar ne "LOG MICRO", i cili prodhin raporte te mjaftueshme financiare si qe jane: Libri i arkesh, Libri kryesor, Raportet e te hyrave dhe shpenzimeve per projekte si dhe Pasqyrat Financiare te OJQ-se si teresi.

### 2.5 Vijimesia

Pasqyra e Pozicionit Financiar dhe Pasqyra e te Ardhurave jane pergatitur mbi bazen e vijimsise, sipas se ciles shoqeria do te jete ne gjendje te realizoi pasurite dhe detyrimet e saja ne rrjedhen normale te OJQ-se.

## 3. POLITIKAT E RENDESISHME TE KONTABILITETIT

### 3.1 Prona, pajisjet dhe impiantet

Prona, pajisjet dhe impiantet jane matur me kosto minus zhvleresimi i akumuluar dhe çdo humbje e akumuluar nga demtimi (rënia në vlerë).

Zhvleresimi ngarkohet në mënyrë që të ndahet kosto e pasurive minus vlera e tyre e mbetur pergjate jetës së përdorimit të parashikuar, duke përdorur metodën lineare. Normat vjetore të mëposhtme janë përdorur për zhvleresimin e pronës, impianteve dhe pajisjeve:

Ndërtesat	5% për qind
Impiantet	10% për qind
Pajisjet, mobilieritë, kompjuterët	20% për qind

Nëse ka një tregues se ka pasur një ndryshim të rëndësishëm në normën e zhvleresimit, jetën e dobishme ose vlerën e mbetur të një pasurie, zhvleresimi i kësaj pasurie rishikohet në mënyrë prospektive për të pasqyruar pritshmëritë e reja.

### 3.2 Instrumentet financiare

Shoqeria mbane vetem instrumente financiare jo-derivative, te perbera nga paraja dhe ekuivalentet e parase, te arketueshmet tregtare, kredite dhe huamarrjet, te pagueshmet tregtare dhe te pagueshmet tjera.

#### *Paraja dhe ekuivalentet e parase*

Paraja dhe ekuivalentet e parase perfshijne: Parane ne arke dhe depozitat rrjedhese te mbajtura ne bankat vendore.

#### *Llogarite e arketurshme tregtare dhe te tjera*

Llogarite e arketueshme tregtare dhe te tjera maten me vleren e drejte dhe jane kerkesa te dala ngaveprimtaria e rregullte dhe qe priten te inkasohen nga debitorët. Ne fund te cdo periudhe raportuese, vlerat kontabel te llogarive te arketueshme tregtare dhe te tjera shqyrtohen per te percaktuar nese ka ndonje evidence objektive qe shumat nuk jane te rikuperueshme dhe nje humbje nga demtimi (renja e vleres) njihet menjehere ne Pasqyren e te Ardhurave.

#### *Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera*

Llogaritë e pagueshme tregtare janë detyrime në bazë të afateve normale të kreditimit dhe nuk bartin interes. Të pagueshmet tregtare të shprehura në monedhë të huaj shprehen në valutën Euro duke përdorur kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimet ose humbjet e këmbimit valutator janë të përfshira në të ardhurat e tjera apo shpenzimet e tjera.

### 3.3 Perfitimet e punonjesve

#### *Kontributet e detyrueshme te sigurimeve sociale*

OJQ- ja kontribon vetem me kontribute per sigurime sociale te detyrueshme qe percaktojne perfitime pensionale per punetoret pas pensionimit. Qeveria e Kosoves eshte kompetente per percaktimin e limitit minimal ligjor te vendosur per pensionet ne Kosove sipas nje plani kontributesh pensionale te percaktuar. Kontributet e kompanise per planin e pensioneve jane ngarkuar ne fitim ose humbje kur kane ndodhur.

### 3.4 Te ardhurat dhe shpenzimet

#### *Te ardhurat nga grantet dhe donacionet*

Te ardhurat nga grantet dhe donacionet njihen si e ardhur ne momentin e inkasimit te tyre, duke e ndare me pastaj ate, ne te ardhurat e periudhes raportuese dhe te ardhurat e shtyra qe i takojne periudhes se ardhshme raportuese. Te hyrat nga aktivitetet ekonomike njihen kur mallrat jane doreuar dhe pronesia eshte bartur si dhe sherbimet jane kryer.

#### *Shpenzimet operative*

Shpenzimet direkte dhe shpenzimet tjera indirekte njihen ne baze akruale qe dmth atehere ato kur ndodhin.

### 3.5 Tatimi mbi te ardhurat

Shoqeria eshte organizate jo profitabile dhe nuk shperndane fitim, keshtu qe sipas legjislacionit ne fuqi nuk eshte subjekt i tatimit ne te ardhura.

### 3.6 Percaktimi i vleres se drejte

Vlera e drejte e parase dhe ekuivalentet e saj, llogarive te arketueshme dhe te pagueshme jane perafersisht te barabarte me vleren e tyre, per shkak te likuiditetit dhe maturimit afatshkurter te tyre.

## 4. PARAJA DHE EKVIVALENTET E PARASE

Paraja dhe ekuivalentet e parase pasqyrojne parane ne banke dhe arke me 31.12.2021.

### Paraja dhe ekuivalentët e parësë

	2021	2020
	€	€
Paraja në arkë	-	-
Banka Prospekt+	0.30	376.69
Banka REACH II	957.29	6,720.97
Banka IKEA		0.00
Banka NEVO	3,311.22	2,713.76
Banka SIDA	838.26	652.21
Banka CDHE	0.00	2.60
	<b>5,107</b>	<b>18,464.83</b>

## 5. PARAPAGIMET

Parapagimet prezantojne pagesat paradhenje per shpenzimet programore dhe ato operative dhe qe njihen si shpenzime te periudhes vijuese te raportimit me date 31.12.2021.

	2021	2020
	€	€
Parapagimet	0.00	0.00
Parapagimet tjera	0.00	22.30
<b>Totali:</b>	<b>0.00</b>	<b>22.30</b>

## 6. PASURITE AFATGJATA

Pasurite afatgjata materiale prezantojne paisjet te cilat OJQ-ja i ka ne shfrytzim dhe qe donatoreve i jane raportuar si shpenzim, nuk ka nje marreveshje mbi bartjen e pronesise se tyre. Pasurite e OJQ-se me 31.12.2021 perbehen nga si me poshte:

Kostoja	Toka €	Ndërtesat €	Pajisjet, mobilitetë, €	Makinat €	Gjithsej €
Më 1 janar 2020	0,00	0.00	31,305.07	0.00	31,305.07
shtesat				0.00	0.00
Zhvleresimi vitit	-	-	(3,593.33)	-	(3,593.33)
Riklasifikimet	-	-	-	-	-
Zhvleresimi akumuluar	-	-	(27,711.74)	-	(27,711.74)
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Zhvlerësimi i akumuluar dhe dëmtimi</b>					
Më 1 janar 2021	00.00	0.00	31,305.07	0.00	31,305.07
(Shitjet)/Shtesat gjatë vitit	-	-	0.00	0.00	0.00
Shitja nen vlere- shlyerje	-	-	-	-	-
Zhvlerësimi i vitit	-	-	-	-	( 0.00)
Zhvl akumuluar paimeve	-	-	(31,305.07)	-	(31,305.07)
Min zhvlerësimi i ak obj	-	-	-	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2021</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>-</b>	<b>0.00</b>
<b>Vlera neto</b>					
<b>Më 31 dhjetor 2021</b>	<b>00.00</b>	<b>-</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>

## 7. Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera

Llogarite e pagueshme prezantojne detyrimet afatshkurtera te dala nga operacionet si dhe te pagueshmet tjera me 31.12.2021 dhe perbehen si me poshte:

	2021 €	2020 €
Të pagueshmet ndaj furnitorëve vendor	0.00	246.30
Të pagueshmet të përlllogaritura tatimore	0.00	0.00
Të pagueshmet per paga	0.00	144.00
Të hyrat e shtyra	0.00	0.00
Te pagueshmet ndaj tatimit ne fitim	0.00	0.00
	<b>0.00</b>	<b>390.00</b>

## 8. DETYRIMET PER TAP, TMB DHE KONTRIBUTE PENSIONALE

Ne tabelen me poshte i prezantojme detyrimet afatshkurtera per te ardhura personale, tatimin e mbajtur ne burim dhe kontributete pensionale:

	2021	2020
Afatshkurtra	€	€
Pagat Neto	0.00	0.00
Tatimet ne paga	0.00	144.00
Kontributete pensionale	0.00	0.00
	<b>0.00</b>	<b>144.00</b>

## 9. FONDET

Ne tabelen me poshte prezantojme fondet e bartura, fondet e kethyera, rritjen apo paksimin e fondeve te periudhes raportuese:

FONDET	2021	2020
Neto Rritje /pakesim te fondeve nga periudha e kaluar	10,099.00	36,927.20
Neto Rritje/pakesim te fondeve nga periudha vijuese	-5,360.00	14,539.14
Kethim donatoreve:	368.00	(15,202.38)
<b>Totali:</b>	<b>5,107.00</b>	<b><u>36,263.96</u></b>

## 10. Të ardhurat

Te ardhurat prezantojne te hyrat e inkasuara nga grantet, donatoret, antaresia dhe aktivitetet ekonomike, te ardh. tjera dhe me date 31.12.2021 perbehen si me poshte:

KFOS	26,972.00	
KKS-Germany	121,203.50	
SIDA	50,461.19	
D4D	1,300.00	
Te ardhurat tjera	1,100.00	
<b>Totali:</b>	<b><u>201,036.69</u></b>	
	<b>2021</b>	<b>2020</b>
	<b>€</b>	<b>€</b>
Neto rritje/pakesim te fondeve nga periudhat e kaluara:	36,263.96	36,927.20
Neto rritje/pakesim te fondeve nga periudha vijuese:	-5,360.00	14,539.14
Kethim donatoreve:	368.00	(15,202.38)
	<b>31,271.96</b>	<b>36,263.96</b>

## 11. Të ardhurat e shtyra (te pa fituara)

Të ardhurat e shtyra prezantojne te hyrat nga grantet dhe donacionet qe jane inkasuar por qe i takojne periudhave vijuese te raportimit .Me date 31.dhjetor 2020 nuk ka te ardhura te pa fituara,ndersa me 2021,gjithashtu nuk ka.

<b>Te ardhurat e shtyra (te pa fituara)</b>	<b>2021</b>	<b>2020</b>
	<b>€</b>	<b>€</b>
Te hyrat e shtyra (REACH II)	0.00	0.00
Te hyrat e shtyra SIDA	0.00	0.00
Te hyrat e shtyra Prospekt+	0.00	0.00
	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>

## 12. SHPENZIMET PROGRAMORE

Shpenzimet programore prezantojne shpenzimet direkte per zhvillimin dhe mbarevajtjen e projekteve per gjate periudhes vjetore . I prezantojme ne tabelen si me poshte:

<b>Shpenzimet programore</b>	<b>2021</b>	<b>2020</b>
	<b>€</b>	<b>€</b>
Pagat bruto dhe meditjet	52,830	52,242.07
Shpenzimet programore	68,906	64,297.73
<b>Totali:</b>	<b>121,796</b>	<b>116,539.80</b>



### 13. SHPENZIMET E ADMINISTRATES DHE MENAXHMENTIT

Shpenzimet e administrates dhe menaxhmentit prezantojne shpenzimet indirekte per zhvillimin dhe mbarevajtjen e projekteve te zhvilluara nga OJQ per gjate periudhes vjetore . I prezantojme ne tabelen si me poshte:

Shpenzimet e administrates dhe menaxhmentit	2021	2020
	€	€
Pagat bruto dhe meditet	83,050	89,623.95
Shpenzimet operative	1,436	8,501.10
Shpenzimet tjera	115	3,593.00
<b>Totali:</b>	<b>84,600</b>	<b>101,718.05</b>

### 14. Ngjarjet pas përfundimit të periudhës raportuese

Menaxhmenti eshte pergjegjes per shpalosjen e ngjarjeve te mevonshme pas dates se perpilimit te pasqyrave financiare qe kerkojne rregullime ose shpalosje. Ne gjate auditimit nuk kemi konstatuar ngjarje pas dates se perpilimit te pasqyrave financiare. Menaxhmenti eshte pergjeges per shpalosjen e ngjarjeve te mevonshme pas dates se perpilimit te pasqyrave financiare por qe nuk kerkojne rregullime te pasqyrave financiare.

Situata e krijuar nga Pandemia "Covid 19" paraqet një ngjarje të mëvonshme që mund të ketë efekt në afarizmin e OJQ-isë dhe paqartësia rreth kohëzgjatjes së kësaj situatë paraqet një pasiguri që mund të ndikoj negativisht në vijimësinë e veprimtarisë së OJQ-se. Menaxhmenti është duke analizuar këtë situatë me qëllim që të zvogëloj implikimet negative të kësaj ngjarjeje. Lidhur me këtë situatë nuk ka patur nevojë të bëhen korrigjime në pasqyrat financiare të vitit që përfundon më 31.12.2021.

### 15. Aprovimi i pasqyrave financiare

Pasqyra financiare janë aprovuar nga menaxhmenti dhe janë autorizuar për publikim më 31.03.2022.